



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:191574  
Datë: 11.03.2024  
Numri i dokumentit: 05470233

**Ac.nr.1433/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M. C., adresa: ..., Prishtinë, përfaqësuar nga B. Sh., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit Sh. A., me adresë në Prishtinë, objekti i kontestit kompensim dëmi për shkak të shpifjes dhe fyerjes, vlera e objektit të kontestit 30,000.00€, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1345/14, datë 11.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e paditësit M. C. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1345/14, datë 11.10.2019, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.1345/14, datë 11.10.2019, gjykata e shkallës së parë ka vendosur: refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit M. C. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që “të vërtetohet së i padituri Sh. A. nga Prishtina me deklarinimin e informatave të pavërteta në mbledhjen e tretë të Kuvendi të Komunës së Prishtinës dhe të publikuara në mjete të informimit ka shpif në dëm të paditësit dhe më këtë edhe e ka fyer të njëjtin, e po ashtu të detyrohet i padituri që paditësit M. C. nga Prishtina t’ia kompensoj dëmin jomaterial në shumë prej 30,000.00 €, në emër të dhimbjeve shpirtërore të përjetuara për shkak të cenimit të

dinjitetit, nderit dhe reputacionit të paditësit, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,479.00 €”, si e pabazuar. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditsi, për shkaqe të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimi të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën si të bazuar, kërkesëpadia e palës paditëse të aprovohet si e bazuar, apo të kthej rastin në rigjykim.

Në shkresa të lëndës nuk mund të gjendet se pala e paditur ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datën 02.05.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, duke kërkuar të vërtetohet se i padituri me deklarata të pavërteta në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës ka bërë shpifje në dëm të paditësit, si dhe e ka fyer të njëjtin.

Pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi, duke kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me propozim që e njëjta të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në arsyetimin e aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se është arritur të vërtetohen faktet se me datë 27.03.2014 në mbledhjen e tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me rastin e diskutimit të pikës së 7 të rendit të ditës, i padituri pas dhënies së fjalës për diskutim dhe paraqitje të pikës diskutuese, i njëjti ka filluar paraqitjen e pikës së 7, e nder çështjet për diskutim ishte edhe propozimi për vendim përfundimtar lidhur me këmbimin e pronës së paditësit sipas vendimit paraprak të Komunës së Prishtinës me numër 01 nr.046-157056, datë 27.08.2013, me pronar paditësin. Më tej ka arsyetuar se në fjalimin e të paditurit në cilësinë e kryetarit të komunës, i njëjti për asnjë moment nuk u është drejtuar asamblistëve duke u thënë së paditësi është falsifikator, përkundrazi, i padituri ka dhënë propozimin e tij që lidhur me këtë çështje saktësisht vendimi për këmbimin e pronave objekt i pikës së 7 të rendit të ditës, ka propozuar që të shtyhet për vendosje kjo pikë e rendit të ditës me arsyetimin që të sigurohet Kuvendi i Komunës së gjithçka është në rregull me këtë pronë dhe i njëjti ka deklaruar “nuk po them së është falsifikator (aludon tek paditësi), por dua të gjejë a është e falsifikuar, në mënyrë që ju pastaj edhe unë vet si ekzekutiv me krejt ekipin, edhe ju si Kuvend të jemi të sigurtë së çka po kalojmë, se kur të na e kthen Gjykata pastaj është procedurë tjetër”.

Po ashtu, situata e paraqitur si me lartë mbështetet edhe nga Audio CD, e paraqitur nga pala e paditur, e cila u dëgjua në prani të palëve ndërgjyqëse në seancën e datës 11.10.2019, si dhe Audio Video CD e shfaqur në televizionin Arta KTV, nga të cilat nuk rezulton asnjë nga pretendimet e palës paditëse.

Gjykata e shkallës së parë më tej ka arsyetuar se i padituri në këtë çështje nuk është përgjegjës për shpifje dhe fyerje edhe për faktin së i njëjti sipas dispozitave të lartcekura ligjore, konkretisht nenit 9 të LCSHF, gëzon imunitet për faktin së deklarimet lidhur me pronën e paditësit, i ka bërë në cilësinë e kryetarit të komunës dhe të shprehura në Kuvendin e Komunës si organ lokal, i cili është organi me i lartë ekzekutiv i komunës, e meqenëse i njëjti mban pozitën me të lartë ekzekutive, është përgjegjësi e tij ligjore që të kujdeset për pronat e komunës dhe mundësisë së keqpërdorimit eventual pasurisë komunale. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ju ka referuar dispozitave të Ligjit Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë janë dhënë arsye. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë mbi bazë të provave që janë propozuar nga përfaqësuesit e ndërgjyqësve, ka arritur që deklaratat që pretendohet se përmbajnë informacion shpifës, ti vërtetoj dhe më pas të cilësohen se nuk përmbajnë shpifje, në këtë mënyrë duke arritur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Po ashtu është vërtetuar se deklarimi i të paditurit i dhënë në mbledhje të Kuvendit Komunal Prishtinë, me datë 27.03.2014 nuk mund të konsiderohet se i përmbushin elementet ligjore shpifjes, ngase në atë mbledhje, bazuar në transkriptin e mbledhjes të datës 27.03.2014, është arritur të vërtetohet se diskutimi për ekzekutimin e vendimit përfundimtar për këmbim të pronës së paluajtshme ka qenë i ngritur në nivel pikës për rend dite, pra asambleja ka diskutuar për këmbim të pronave. Po ashtu nga ai procesverbal, është vërtetuar se i padituri në foltore të kuvendit në cilësi të kryetarit të komunës, ka shprehur

dyshimet se kontrata e shitblerjes së lidhur mes babait të paditësit dhe N. Ja., ka mundur të jetë e falsifikuar, prandaj vendimi për këmbimin e pronave nuk ka mundur të bëhej sipas tij. Po ashtu nga ai procesverbal ishte arritur të vërtetohet se paditësi kishte ngritur çështjen se si paditësi e përfaqësonte shitësin, në raport kontraktual, kurse në anën tjetër si blerës ishte babai i tij. Për sa i përket faktit nëse i padituri e ka quajtur paditësin si falsifikator, në seancën e kuvendit komuna datë 27.03.2014 ndër të tjera i padituri ka deklaruar se “nuk po themi se është falsifikator, por dua të gjejë a është e falsifikuar, në mënyrë që ju pastaj dhe unë vet si ekzekutiv me krejt ekipin, edhe ju si kuvend të jemi të sigurt se çka po kalojmë, se kur te kthen gjykata pastaj është procedurë tjetër”.

Për sa i përket shkrimeve që janë publikuar në të përditshme Koha Ditore lidhur me çështjen në fjalë, nga disa shkrime mund të vërehet se bëhej fjalë për “Dyshime për falsifikim pronash në Gërmi”, pra theksi nuk është vënë tek paditësi, por tek çështja që kishte të bënte me vet procesin e shkëmbimit të pronave, për të cilat kishte dyshime të ngritura. Sido që të jetë, ndonëse paditësi ka përmendur në ankesë këto shkrime, media e cila ka publikuar nuk është palë në procedurë, si dhe as i padituri nuk është person që ka shkruar të njëjtat, por janë interpretime të bëra nga subjekte tjerë. Lidhur me pretendimin ankimor përkitazi me faktin se nuk është vlerësuar përmbajtja nga CD, e cila përmban intervistën e të paditurit në TV Arta, Gjykata e shkallës së parë, gjithashtu drejtë ka arritur në përfundim se në atë intervistë, i padituri nuk kishte dhënë cilësime të drejtuara paditësit se ai është falsifikator, porse i padituri ka shprehur qëndrimet e tij si person zyrtar karshi një procesi, që sipas tyre përmban të meta. I padituri me datë 12.07.2023, ka plotësuar ankesën në kuptim të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, duke dërguar një aktakuzë të ngritur ndaj të paditurit, mirëpo plotësimi i tillë i bërë mbi tre vite që nga koha e parashtrimit të ankesës fillestare, nuk mund të pranohet. Gjithashtu, në kohën kur gjykata e shkallës së parë ka nxjerr vendimin meritor, prova e tillë nuk ka ekzistuar.

Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë, gjykata e shkallës së parë ka arritur që të bëjë vlerësimin e saj në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-65 - Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Nga analizimi i thënieve në ankesë, nuk është gjendur se cilat ishin ato prova që gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të gabuar, në atë mënyrë që ka keq interpretuar përmbajtjen e tyre, apo se nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, duke bërë të njohur për këtë gjykatë se një prove e caktuar do të dërgonte tek një gjendje tjetër faktike.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimin ankimor në mënyrën e elaboruar nga pala ankuese, për sa i përket aplikimit të së drejtës materiale, ndonëse për këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, duke gjetur si pretendim të pa bazuar, ngase gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar të njëjtën. Në nenin 3 pika a) të Ligjit Nr. 02/L-65 - Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (LCKShF), është definuar se: “*Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.*” Ndërsa, në pikën b) të kësaj dispozite përcaktohet se: *Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese*”. Lidhur me përgjegjësinë për shpifje dhe fyerje Ligji në nenin 5 par.1 ka paraparë se: “*Një person është*

*përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësisë në pajtim me këtë Ligj". Po ashtu Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 40 ka garantuar lirinë e shprehjes, duke paraparë: *Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. 2. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.**

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje kur ka cilësuar se deklaratimet e të paditurit nuk përbëjnë shpifje, pasi që bazuar në gjendjen faktike, drejtë është arritur deri tek përfundimi në drejtim të refuzimit të padisë duke aplikuar të drejtën materiale.

Gjykata e Apelit, bazuar në nenin 2 të LCKSHF dhe nenit 53 të Kushtetutës, sipas të cilave gjykata është e detyruar të interpretoj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, respektivisht me këtë ligj në harmoni me vendimet GJEDNJ. Në këtë mënyrë GJEDNJ ka theksuar "Liria e shprehjes përbën një nga themelet kryesore të një shoqërie demokratike, dhe një nga kushtet bazë për përparimin e saj dhe për përmbushjen vetjake të çdo individi" (GJEDNJ *Handyside kundër Britanisë së Madhe*, Aktgjykimi i datës 7 Dhjetorë 1976; *Lingens kundër Austrisë*, 1986, Aktgjykimi i datës 8 Korrik 1986, paragrafi 41). Parimet e përgjithshme që rrjedhin nga praktika e GJEDNJ lidhur me atë nëse kufizimi i lirisë së shprehjes në raport me mbrojtjen e reputacionit në të tilla raste është i nevojshëm në një shoqëri demokratike, që janë dhënë në disa çështje të mëparshme rasti Couderc dhe Hachette Filipachi asociats kundër Francës rasti me nr.40454/07 par.82-93 aktgjykimi i dt.10.11.2015.

Qëndrim e shprehur në vendimin e shkallës së parë, e përkrah edhe kjo gjykatë, për faktin se i padituri në cilësi të kryetarit të komunës, në seancë të Kuvendit Komunal ka dhënë pikëpamjet e tij që lidheshin me pikën e rendit të ditës, pra çështja e këmbimit të pronave, nga i cili edhe rasti kontestues ka zënë fill, ishte ngritur në nivel të diskutimit në asamble komunale. Qëndrimi i të paditurit se nuk do të ekzekutonte një kontratë, për të cilën kishte dyshime se ishte e falsifikuar, i kishte shkrehur edhe në foltore të kuvendit komunal, po ashtu sipas tij, ai i bënte këto veprime me qëllim të mbrojtjes së pronës publike. Vihet në dukje një element me rëndësi se i padituri kryesisht deklaratimet e kishte dhënë si pikënisje tek prona komunale dhe në lidhje me pronën, kurse paditësi është i përfshirë në diskutime si pasojë që derivonte nga ekzekutimi i vendimit për këmbim të pronave. Pra, nga përmbajtja e deklaratimeve të paditurit, nuk mund të nxirret përfundimi se qëllimi i deklaratimeve ishte paditësi, porse personi që ishte subjekt i këmbimit të pronës. Gjithashtu nga analizimi i paraqitjes së të paditurit në emision në "TV Arta", vërtetohet si ai si qëllim nuk kishte paditësin, por sipas tij mbrojtjen e pronës komunale. Në vlerësim të këtij interpretimi gjykata gjen se duhet të bën dallim me qëllimin e deklaratimit, ashtu që në rastet kur një deklaratim i referohet masës së gjerë me qëllim të përhapjes së një informacioni qëllimi i së cilit do të ishte njollosja, shpifja, ofendimi me dashje i një personi, me rrethanat tjera kur deklaratimi i drejtohet anëtarëve të kuvendit komunal, si qëllim kontestimin e një veprimi juridik.

Sipas nenit 9 pika b) të LCKShF, rregullohet se deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij Ligji nëse i padituri dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim: *çdo deklaratë e bërë gjatë punimeve në organet e pushtetit lokal nga anëtarët e këtyre organeve*. Rrjedhimisht gjykata në kuptim të këtij neni, bazuar në pjesën e deklarimeve që i kishte dhënë në foltore të kuvendit komunal për pikë të rendit të ditës, nuk mund të konsiderohet se ka dhënë deklarime më përmbajtje shpifëse.

Gjykata e Apelit vlerëson se duke vlerësuar temën dhe kontekstin e deklarimeve të të paditurit, nuk mund të bëhet fjalë për deklarime që në vete përmbajnë shpifje, ngase paditësi nuk ishte subjekt kryesor i deklaratës, porse veprimet juridike që ishin në kompetencë të Komunës së Prishtinës për t'u ndërmarrë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, porse nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura më lartë, Gjykata e Apelit në bazë të nenit nenin 194 dhe 195 par. 1 pika d), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**  
**Ac.nr.1433/2020, datë 11.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari**  
**Dardan Kadolli**